



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:086323

Datë: 09.02.2024

Numri i dokumentit: 05307328

AA.nr.296/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Y.Sh nga Lipjani, të cilin me autorizim e përfaqëson nga avokat Shpëtim Sadiku nga Lipjani, kundër të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1039/2022, të datës 07.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit Y.Sh nga Lipjani, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1039/2022 i datës 07.03.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1039/2022, të datës 07.03.2023, në pikën I të dispozitivit është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Y.Sh nga Lipjani, kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilën ka kërkuar të anulohet vendimin i të paditurës A.nr.126/2022 datë 14.03.2022 dhe vendimi i datës 21.12.2018, konkursi nr.ref ASK-DLLK-001 të përsëritet, të anulohet vendimi për përzgjedhjen e kandidatit për pozitën Drejtor Departamenti të Llogarive Kombëtare. Ndërsa në pikën II të dispozitivit është vendosur qe secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë i autorizuari i paditësit avokat Shpëtim Sadiku nga Lipjani për shkak të: zbatimit të gabuar të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të se drejtës material. Me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa në tersi si e bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar ose çështjen ta kthej në riprocedurë dhe rivendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë, me vendimin A.nr.126/2022, të datës 14.03.2022, e ka hedhur poshtë si të pa lejuar ankesën me nr. A.nr. 30/2019 të datës 21.01.2019 të parashtruar nga ankuesi Y.Sh nga Lipjani.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, si në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor, e duke u bazuar në provat dhe dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke lënë në fuqi vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Me arsyetim se gjykata e shkallës së parë fillimisht kishte parasysh se palë e paditur në këtë procedurë të konfliktit administrativ ishte Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil dhe se kërkesa për përsëritje konkursi si dhe anulimin e vendimit të organit punëdhënës është e pa pranueshme fillimisht mbi bazën se organ punëdhënës është Agjencia e Statistikave dhe ky organi administrativ sipas padisë nuk paditet në këtë procedurë (Gjykata këtu kishte parasysh se në kuptim të dispozitës nenit 20 të LLA-së organ i paditur është organi akti administrativ i të cilës kërkohet të anulohet), në mënyrë që të njëjtës Gjykatë ti ngarkoj detyrimet duke mos ja dhënë mundësin e deklarimeve dhe ballafaqimit në këtë procedurë. Po ashtu parashtrimi i kërkesës për anulimin e vendimit për përzgjedhjen në pozitën Drejtori i Departamentit të Llogarive Bankare, propozimi-kërkesa si i tillë është i palejueshëm në Gjykatë për faktin se një kërkesë e tillë nuk është adresuar fillimisht te e paditura, nuk janë shtjerrë mjetet juridike në mënyrë që të zgjerohet kërkesa në këtë procedurë të konfliktit administrativ edhe ndaj këtij vendimi. Duke pasur parasysh se lidhur me këtë çështje është zhvilluar një herë procedurë gjyqësore në këtë kuptim, gjykata e shkallës së parë u lëshua në merita të shqyrtimit të lëndës. Nga vendimi i atakuar konstatohet hedhja poshtë e ankesës e këtu paditësit si e palejueshme. Gjykata e shkallës së parë këtu kishte parasysh 19 dhe 20 të Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Me vendimin e datës 05.12.2018 nr.368/2018-KPMSHCK aprovohet si e rregullt procedura e rekrutimit për pozitën Drejtor i Departamentit të Llogarive Kombëtare në Agjencinë e Statistikave sepse është zhvilluar në pajtim me dispozitat e nenit 18 të Ligjit për Shërbimin Civil, rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregullores nr.05/2012 për Klasifikimin e vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe obligohet organi punëdhënës që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të bëjë zbatimin e tij. Me ankesën e datës 21.01.2019 pranë të paditurës adresohet propozimi për anulim të vendimi të datës 21.12.2018, të përsëritet procedura, që vendimi të sqaroi të gjitha shkeljet që rekrutimi në institucionet e shërbyesve civil të bëhet në bazë të meritës së profesionalizimit, paanshmërisë.

Andaj mbi bazën e këtyre konstatimeve ku nga ankesa e adresuar pranë të paditurës kërkohet anulimi i vendimit të organit punëdhënës dhe sqarimi i të gjitha shkeljeve dhe që rekrutimi të bëhet mbi bazën e meritës profesionalizimit, paanshmërisë e mbi bazën e të cilës kërkesë, gjykata e shkallës së parë kishte parasysh se me vendimin e datës 05.12.2018, aprovohet si e rregullt procedura e rekrutimit për

pozitën drejtor i Departamentit të Llogarive Kombëtare, Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se kërkesa si e tillë konstatohet si e pabazuar, për faktin se e gjithë kërkesa e cila referohet në përsëritje të procedurës dhe konstatimin e shkeljeve është e pabazuar kur veç se në kuptim të nenit 20 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës kjo procedurë e rekrutimit është konstatuar si e rregullt dhe i cili vendimi është përfundimtar në procedurë administrative, i njëjti nuk është atakuar nga asnjë palë referuar shkresave të lëndës. Andaj përderisa në kuptim të nenit 19 të Ligjit nr.06/L-048 është aprovuar procedura si e rregullt me vendimin e datës 05.12.2018, andaj duke pasur parasysh se në kuptim të nenit 21 të po këtij Ligji vendimi i këshillit është përfundimtar dhe përderisa nga shkresat e lëndës nuk është konstatuar se i njëjti është atakuar me padi apo se i njëjti është konstatuar i kundërligjshëm, në kuptim të nenit 23 dhe 24 të ligjit të sipër cituar lind edhe pasoj e mos ekzekutimit, andaj në këtë kuptim dhe inicimi i ankesave lidhur me po këtë procedurë të rekrutimit është i pabazuar përballë kësaj gjendjeje faktike të konstatuar nga vet e paditura kur ka aprovuar si të rregullt procedurën e rekrutimit. Gjykata e shkallës së parë kishte parasysh edhe formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ të atakuar dhe mbi këtë bazë kishte parasysh se e paditura është dashur të shqyrtoj ankesën dhe me vendim të vendos lidhur me ankesën mbi bazën e konstatimit të gjendjes faktike dhe të refuzoj ankesën/ kërkesën e saj e jo të hedh ankesën si të palejueshme. Mirëpo gjykata e shkallës së parë është lëshuar në shqyrtimin e çështjes dhe ka konstatuar se padia duhet të refuzohet duke mare parasysh se lidhur me këtë çështje veç se është vendosur një herë me aktgjykim dhe se nuk janë ofruar prova për të konstatuar një gjendje tjetër faktike nga kjo e konstatuar si në këtë vendim. Gjykata e shkallës së parë kishte parasysh se paditësi pranë të paditurës ka parashtruar ankesën referuar procedurës së rekrutimit, përsëritjes të të njëjtës, e në fakt me vendimin të datës 05.12.2018 të këtu të paditurës veç se është konstatuar proceduar e rekrutimit si e rregullt, në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë e refuzoi padinë dhe kërkesën e saj. Paditësi para Gjykatës nuk ka ofruar prova bindëse me të cilat do të argumentonte pretendimet e tij për konstatimin e një gjendjeje tjetër nga kjo e konstatuar me vendim. Gjykata e shkallës së parë kishte parasysh edhe pretendimet e paditësit por se të njëjtat nuk i aprovoi sepse ishin në kundërshtim me gjendjen faktike të konstatuar në këtë shqyrtim gjyqësor dhe mbi bazën se pretendimet e këtu paditësit referohen në procedurën e rekrutimit dhe provave rreth kësaj procedure dhe mos plotësimit të kushteve me referim në kandidatë përkatës, e ku Gjykata kishte parasysh se me vendimin e datës 05.12.2018 është aprovuar si e rregullt procedura e rekrutimit, në të cilin referohet edhe përvoja e punës për kandidatin e rekomanduar, e që Gjykata kishte parasysh se ky vendim është përfundimtar në procedurë administrative dhe se i njëjti nuk është argumentuar se është atakuar nga këtu paditësi.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave procedurale të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurit në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe në mungesë të saj juridikisht fare nuk ka vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, por ka konstatuar një gjendje faktike që nuk ka qenë objekt shqyrtimi sipas padisë. Pra nëse shikohet me kujdes paditësi me datën 04.12.2018 ka ushtruar ankesë të Agjencia e Statistikave të Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi për përzgjedhje dhe të përsëritet konkursi. Ndërsa gjykata e shkallës së parë, thirret në vendimin e të paditurës të datës 05.12.2018 pra paditësi ka filluar procedurën administrative para se të lëshohet vendimi i të paditurës 369/2018 i datës 05.12.2018. Po ashtu nëse ju referohemi datës së Agjencisë së Statistikave kur ka vendosur lidhur me ankesën e paditësit, vendimi i këtij institucioni është i datës 21.12.2018, pra këtu lind dyshimi se nëse e paditura me vendimin e saj 369/2018 të datës 05.12.2018 e ka legjitimuar procedurën e rekrutimit dhe të njëjtin vendim ia ka komunikuar edhe Agjencionit të Statistikave të Kosovës, përse ky institucion kur ka nxjerr vendimin e saj me datën 21.12.2018 nuk e ka hedh poshtë ankesën dhe ta njoftoj paditësin se lidhur me ankesën ndaj konkursit tani e paditura me vendimin e saj e ka legjitimuar procedurën e rekrutimit sipas konkursit. Fundja nga data kur e paditura e ka nxjerr vendimin 05.12.2018 e deri me datën 21.12.2018 kur ka vendosur Agjencioni i Statistikave, paditësi sikur të ishte udhëzuar drejt apo sikur Agjencioni i Statistikave të kishte vendosur në një formë tjetër në një arsyetim tjetër ka qenë brenda çdo afati ligjor që paditësi të inicioj konflikt administrativ ndaj vendimit të paditurës 369/2018 të datës 05.12.2018. Pastaj se e paditura por edhe gjykata nuk e ka vërtetuar një fakt se me rastin e përzgjedhjes së kandidatit fare nuk e ka vërtetuar se i njëjti përvojën e punës ta ketë vërtetuar nga pasqyra e Trustit Pensional si dhe vërtetimin nga ATK që dëshmon faktin se ka qenë në marrëdhënie pune dhe çfarë pozite ka pasur në atë ndërmarrje private, duke ju referuar të dhënave nga web faqja e ATK-së kjo ndërmarrje është jo aktive. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase konsideron se të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara. Sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe gjykata e shkallës së parë, si dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Ngase paditësi me asnjë provë nuk ka argumentuar vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike kjo gjykatë vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë si rezultat i shkeljeve të dispozitave procedural dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike gabimisht ka aplikuar dispozitat materiale pasi që realisht fare nuk ka vendosur për kërkesëpadinë e paditësit por ka legjitimuar një procedure administrative për të cilën qoftë me fajin e të paditurës nuk është vendosur meritore lidhur me procedurën administrative të cilën e ka iniciuar paditësi e po ashtu gjykata e shkallës së parë ka vendosur me aktgjykimin e saj në kundërshtim me dispozitën e nenit 22 par. 1 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e cila ka paraparë të drejtën për një proces të rregullt. Ky kolegji këto pretendime vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme për tu aprovuar ankesa, ngase me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë ka bërë administrimin e provave dhe atë: aktgjykimin A.nr.945/19,të dt.03.02.2022, vendimin e dt.14.03.2022, vendimin e dt.21.12.2018,vendimin e dt.05.12.2018, ankesën e dt.21.01.2019, 04.12.2018, kërkesën e dt.28.03.2019, përgjigjen në ankesë te dt.28.03.2019, kërkesën e dt.08.01.2019, konkurs për pozitën drejtor i Departamentit të Llogarive Kombëtare, CV e paditësit, formularin për vlerësimin e rezultateve në punë, dt.28.12.2017, 28.12.2018, akt emërimin e dt.02.10.2015, marrëveshjen e dt.11.11.2015, certifikatën e dt.09/2019, 2014, 2013, 2012, 2010, 2016, 2013, 2010, 2015, 2010, 2003, diplomën 2003, rekomandim i dt.03/2009, pasqyra e

Llogarisë, dt.01.08.2002, 15.01.2019, vërtetimin tatimor të dt.18.01.2019, komunikim elektronik i dt.08.11.2018, renditja përfundimtare e kandidatëve, dt.12.11.2018, vlerësimin individual të kandidatëve për vendin e punës si dhe shkresat përcjellëse, gjendja e përgjithshme dhe transaksioneve. Duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e lartcekura, kolegji vlerësoi se aktgjykimi i ankimuar është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike e juridike. Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të paditësit por të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njëjtat nuk i ka provuar me asnjë provë, në gjykatën e shkallës së parë e as me ankesën e ushtruar në këtë gjykatë.

Prandaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate vendimi i kontestuar i të paditurit dhe aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore të lartcekura, dhe si i tillë aktgjykimi është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të lartcekur, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë, e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.296/2023, me datë 07.02.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi